

VENDIM
Nr.25, datë 19.1.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1282, DATË 23.12.2009, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTËN E PRANIMIT DHE TARIFËN E SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E
CIKLIT TË TRETË, TË STUDIMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA, NË FAKULTETIN E
MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.2, 34, 35 dhe 75, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.1282, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuota e pranimi në programet e ciklit të tretë, të studimeve specializuese afatgjata, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, të jetë 446, e ndarë në specialitete, sipas shtojcës nr.1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha